



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**

**TRANSFERIMIN VULLNETAR DHE TRANSFERIMIN E DETYRUAR TË  
ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. 192, datë 01.11.2024*

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave, afateve kohore dhe përbajtjes së kontratës së transferimit vullnetar dhe transferimit të detyruar të administrimit të fondit të pensionit privat, likuidimin e vetë fondit dhe çregjistrimin e tij nga regjistri, si dhe shpërndarjen e anëtarëve të fondit në fonde të tjera.

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 44, pika 5, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

## **Neni 4**

### **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore do të zbatohet nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat të licencuara, për të gjitha procedurat për transferimin vullnetar dhe të detyruar të administrimit të fondit të pensionit privat.

## **Neni 5**

### **Transferimi vullnetar i veprimtarisë së administrimit të fondit të pensionit**

1. Shoqëria administruese (shoqëria transferuese) ka të drejtë të transferojë administrimin e fondit të pensionit privat në një shoqëri tjetër administruese (shoqëria marrëse) vetëm me miratimin e Autoritetit.
2. Transferimi i propozuar i njoftohet paraprakisht Autoritetit, i cili jep miratimin përpara kryerjes së transferimit.
3. Shoqëria transferuese duhet të informojë anëtarët e fondit të pensionit nën administrim 3 muaj përpara transferimit. Gjatë kësaj periudhe nuk zbatohet asnjë komision transferimi për transferimin e aktiveve dhe asnjë penalitet nëse anëtari tërheq aktivet nga fondi i pensionit.
4. Shoqëria transferuese që transferon të drejtën për administrimin e fondit të pensionit, nënshkruan një kontratë me shoqërinë marrëse. Kontrata duhet të përmbajë të paktën:
  - a. përshkrimin e detajuar të të gjitha procedurave dhe veprimeve, që do të ndërmerren nga të dyja shoqëritë për transferimin e administrimit;
  - b. planin e implementimit, me afate konkrete, brenda të cilit do të kryhet transferimi i veprimtarisë së administrimit të fondit. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të transferimit nga Autoriteti dhe publikimit të njoftimit sipas nenit 8, pika 1, të kësaj rregullore.

## **Neni 6**

### **Kërkesa për miratimin e transferimit të administrimit të fondit të pensionit privat**

1. Shoqëria administruese që kërkon të transferojë administrimin e fondit të pensionit duhet të depozitojë një kërkesë për miratimin e transferimit pranë Autoritetit. Kërkesës për miratimin e transferimit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si më poshtë:
  - a. vendimi i asamblesë së përgjithshme të shoqërisë për transferimin e administrimit të fondit të pensionit tek një shoqëri tjetër administruese;
  - b. kontrata për transferimin e veprimtarisë të administrimit të fondit midis shoqërisë transferuese dhe shoqërisë marrëse, sipas pikës 4, të nenit 5, të kësaj rregullore dhe nenit 42, pika 4, të Ligjit;
  - c. procedura e njoftimit të anëtarëve të fondit të pensionit sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 8, të kësaj rregullore;
  - ç. kontrata e ndryshuar me depozitarin për kryerjen e veprimtarive të depozitarit;
  - d. nëse është e nevojshme, çdo dokumentacion tjetër, sipas kërkesës të Autoritetit.

## **Neni 7**

### **Refuzimi i miratimit të transferimit**

1. Autoriteti refuzon miratimin e kërkesë për transferimin e administrimit të fondit të pensionit nëse:
  - a. shoqëria administruese marrëse nuk plotëson kërkesat për administrimin e fondit të pensionit;
  - b. procedura e informimit të anëtarëve të fondit të pensionit dhe njoftimi për transferimin e fondit nuk është në përputhje me dispozitat dhe kërkesat e nenit 8, pika 1 dhe 2 të kësaj rregullore;
  - c. vlerëson se transferimi i administrimit të fondit të pensionit mund të dëmtojë interesin e anëtarëve të fondit.
2. Kërkesa për dhënien e miratimit për transferimin e veprimtarisë të administrimit të fondit duhet të paraqitet nga shoqëria administruese transferuese. Paraqitja e kërkesës nga shoqëria marrëse përbën shkak për refuzimin nga Autoriteti.

## **Neni 8**

### **Njoftimi i anëtarëve të fondit pas miratimit të transferimit**

1. Shoqëria transferuese dhe shoqëria marrëse brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga marrja e miratimit të Autoritetit për transferimin e veprimtarisë të administrimit, janë të detyruara të publikojnë bashkërisht një njoftim.
2. Njoftimi publikohet në një vend të dukshëm në faqet e internetit të secilës shoqëri, dhe përmban informacionin si më poshtë:
  - a. informacion mbi shoqërinë administruese që merr përsipër administrimin e fondit;
  - b. të gjitha veprimet që do të ndërmerren në lidhje me transferimin e administrimit, në kuadër të transparencës për anëtarët e fondit;
  - c. periudhën brenda të cilës aktivet nën administrim do t'i transferohen shoqërisë marrëse;
  - ç. të drejtën e anëtarit të fondit të pensionit që do të transferohet, gjatë procesit të transferimit të administrimit të fondit.
3. Informacioni i mësipërm u njoftohet anëtarëve të fondit të pensionit edhe me shkresë ose me anë të postës elektronike.
4. Shoqëria transferuese dhe shoqëria marrëse, duhet të përfundojnë të gjitha procedurat dhe veprimet e nevojshme për transferimin e veprimtarive të administrimit të fondit, brenda 1 (një) muaji nga data e publikimit të njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni si dhe të paraqesin një informacion në Autoritet për të gjitha procedurat dhe veprimet e ndërmarra.
5. Përgjashtimisht, me kërkesë të përbashkët të shoqërisë transferuese dhe shoqërisë marrëse, Autoriteti mund të zgjasë afatin e përmendur në pika 4, të kësaj rregullore, vetëm një herë dhe jo më shumë se 1 (një) muaj, nëse është në interes të anëtarëve të fondit. Kërkesa për zgjatjen e afatit duhet të paraqitet nga shoqëria transferuese dhe shoqëria marrëse në Autoritet përpara përfundimit të afatit të përmendur në pikën 4, të kësaj rregullore.

## **Neni 9**

### **Rastet e transferimit të detyruar të administrimit të fondit të pensionit**

1. Shoqëria administruese është e detyruar të transferojë administrimin e fondit të pensionit tek një shoqëri tjetër administruese nëse:
  - a. Autoriteti heq licencën e shoqërisë administruese për administrimin e fondit të pensionit;
  - b. Ndaj shoqërisë administruese janë hapur procedurat e falimentit ose procedurat e likuidimit;
  - c. Autoriteti kompetent i vendit anëtar pritës ndalon që shoqëria administruese në Republikën e Shqipërisë të administrojë një fond me pjesëmarrje të mbyllur në territorin e atij vendi anëtar;
  - ç. Autoriteti i ndalon shoqërisë administruese të një vendi anëtar të administrojë një fond me pjesëmarrje të mbyllur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
  
2. Autoriteti pasi vlerëson situatën sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, vendos miratimin e transferimit të administrimit të fondit të pensionit privat, në një shoqëri tjetër administruese (shoqëri marrëse).

## **Neni 10**

### **Procedura për përzgjedhjen e shoqërisë administruese për transferimin e detyruar të administrimit të fondit të pensionit**

1. Shoqëria administruese brenda 60 ditëve nga data e shfaqjes së rrethanave të parashikuara në pikën 1, të nenit 43, dhe pikën 2, të nenit 46, të ligjit, publikon një ftesë publike për shoqëritë e interesuara në faqen e saj të internetit, si dhe njofton me shkrim Autoritetin.
  
2. Ftesa publike u drejtohet të gjitha shoqërive të licencuara që janë të interesuara dhe që plotësojnë kushtet për administrimin e një fondi pensioni privat. Shoqëritë administruese të interesuara duhet të paraqesin ofertën për administrimin e fondit të pensionit brenda 15 ditëve.
  
3. Shoqëria administruese transferuese në përzgjedhjen e shoqërisë marrëse merr në konsideratë interesat e anëtarëve të fondit të pensionit, si dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
  - a. punën, suksesin dhe rezultatet e deritanishme të shoqërisë administruese marrëse;
  - b. reputacionin e anëtarëve të organeve drejtueseve të shoqërisë administruese marrëse;
  - c. përputhshmërinë e shoqërisë administruese me dispozitat e ligjit dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij;
  - ç. përmbushjen në kohë dhe në mënyrë të rregullt të detyrimeve të shoqërisë administruese;
  - d. bashkëpunimin e shoqërisë administruese me anëtarët;
  - dh. bashkëpunimin e shoqërisë administruese me depozitarin;
  - e. bashkëpunimin e shoqërisë administruese me Autoritetin, veçanërisht në procedurat e mbikëqyrjes; dhe

- ë. kritere të tjera përkatëse për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat.
- 4. Shoqëria administruese që transferon të drejtën e administrimit dhe shoqëria administruese marrëse lidhin kontratën për transferimin e administrimit të fondit të pensionit privat, sipas pikës 4, të nenit 5, të kësaj rregullore dhe pikës 2, të nenit 44, të ligjit.
- 5. Autoriteti miraton ose refuzon transferimin e detyruar të administrimit të fondit të pensionit sipas parashikimeve të nenit 6 dhe 7 të kësaj rregullore.

### **Neni 11**

#### **Njoftimi i anëtarëve të fondit pas miratimit të transferimit të detyruar**

1. Shoqëria administruese transferuese brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga marrja e miratimit të Autoritetit për transferimin e veprimtarisë të administrimit, publikon një njoftim për anëtarët e fondit të pensionit.
2. Njoftimi publikohet në një vend të dukshëm në faqen e internetit të shoqërisë, dhe përmban informacion si më poshtë:
  - a. arsyen e transferimit të detyruar të administrimit;
  - b. informacion mbi shoqërinë administruese që merr përsipër administrimin e fondit dhe kriteret e përdorura në atë përzgjedhje;
  - c. të gjitha veprimet që do të ndërmerren në lidhje me transferimin e detyruar të administrimit të fondit në kuadër të transparencës për anëtarët;
  - ç. periudhën brenda të cilës aktivet nën administrim do t'i transferohen shoqërisë marrëse;
  - d. të drejtën e anëtarit të fondit të pensionit që do të transferohet, gjatë procesit të transferimit të administrimit të fondit.
3. Të gjitha procedurat dhe veprimet që do të ndërmerren në lidhje me transferimin e detyrave të administrimit.
4. Shoqëria transferuese dhe shoqëria marrëse, duhet të përfundojnë të gjitha procedurat dhe veprimet e nevojshme për transferimin e veprimtarive të administrimit të fondit, brenda 1 (një) muaj nga data e publikimit të njoftimit sipas pikës 1, të këtij neni dhe të paraqesin një njoftim në Autoritet për të gjitha procedurat dhe veprimet e ndërmarra.

### **Neni 12**

#### **Çregjistrimi i fondit të pensionit privat**

1. Pas përfundimit të procedurës së transferimit vullnetar të fondit të pensionit në një shoqëri tjetër administruese, Autoriteti pasqyron ndryshimet përkatëse në regjistrin e fondeve sipas

rregullores nr. 143, datë 28.08.2024 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara, njohura, regjistruara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

2. Pas përfundimit të procedurës së transferimit të detyruar të fondit të pensionit në një shoqëri tjetër administruese, Autoriteti revokon licencën e shoqërisë administruese, si dhe pasqyron ndryshimet përkatëse në regjistrin e fondeve sipas rregullores nr. 143, datë 28.08.2024 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuara, njohura, regjistruara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

### **Neni 13**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.